



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/ 361

Datë: 14.07.2023

PROCESVERBAL

i mbledhjes së-I- (parë) urgjente të Kuvendit Komunal të Malishevës

RENDI DITËS

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme 2024-2026

Mbledhja u mbajt me datë: 30.06.2023 dhe filloi në ora: Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: 25 asambleistë, drejtorë komunal, dhe zyra për informim. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Malishevës z. Argjend Thaçi.

Argjend Thaçi: Përshëndetje për të gjithë!

Mirë se keni ardhur në mbledhjen e parë urgjente të Kuvendit të Malishevës. Kush është për miratimin e rendit të ditës?

Për: 15

Kundër: 10

Abstenim: 1

Me 15 vota për, 10 kundër dhe 1 abstenim, miratohet rendi i ditës.

Për të prezantuar këtë pikë e ftoj drejtorin Blerim Thaçi.

Blerim Thaçi: Përshëndetje për të gjithë!

Sot është data 30 qeshor, dita e fundit për aprovimin e kornizës afatmesme buxhetore. Korniza afatmesme buxhetore për vitin 2024 përmban këta kufij buxhetorë: paga dhe medijtje 10,298,787.00E, mallra dhe shërbime-1,742,707.00, komunal -655,000.00E, subvensione dhe transfere-400,000.00E, Investime kapitale 7,299,312.00, Totali-20,395,806.00E. Te qështja e rritjes së buxhetit sipas planifikimit të qeveris është 19,895,800.00E dhe ne duke i rritur të hyrat me 500.000.00E ka mbërritur në shumën 20,395,806.00E. Ne vitin 2024 nga qeveria është parapar një zvoglim i tavanit të të hyrave dhe në komunën tonë. Në projektligjin që është duke u përgaditur për lirim nga tatimi për vitin 2023 deri në

vlerën 100E, për këtë arsye e kanë bërë zvogëlimin e tavanit të të hyrave komuale. Ne në fund të korrikut ne parashikojmë realizimin e qind për qind të të hyrave vetanake të këtij vit, dhe deri në fund të vit realizimi i të hyrave do jetë mbi planifikimi që është paraparë për vitin 2023. Dhe në bazë të kësaj e kemi menduar dhe besoj që dhe vitin e ardhshëm, përkundër asaj që do bëhet projekligji, ne kemi planifikuar që të hyrat për vitin 2024 të kapin vlerën 1,400,160.899E. Kërkoj nga ju që të bëhet aprovimi pasi sot është dita e fundit.

Argjend Thaçi: Hapi debatin për këtë pikë të rendit të ditës. Urdhëro, Nebih!

Nebih Bibaj: Përshëndetje për të gjithë!

Drejtori, tha që është dita fundit që të miratohet korniza. Ku keni qenë deri sot?

Kuvendi nuk duhet të trajtohet në këtë formë, sepse kuvendi ka legjitimitet. Kjo Korniz ka mundur të kryhet dhe javën e kaluar. Nuk e di si mbahet kjo mbledhje kur as në faqe të komunës nuk është publikuar ky takim që po e mbajmë ne.

Drejtor, e kam një pyetje për qështjen e KAB-it, a do duhet që të dal në dëgjim publik kjo pjesë, sepse unë mendoj që po. Jam shumë i shqetësuar që janë duke u zvarritur qështjet në ditën e fundit, sepse kemi pasur kohë dhe më herët që ta analizojmë. Duhet të ketë formë bashkëpunimi, sepse nesër do keni nevojë dhe për ne, për njerëz të këtij Kuvendi. Nuk ka diqka të jashtëzakonshme këtë duhet ta kuptoni të gjithë, nuk ka as ndonjë djegie që të thirret mbledhje urgjente.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil!

Halil Morina: Përshëndetje për të gjithë!

Ajo çka mua më bëri përshtypje është fakti që ekzekutivi i komunës tonë heq fonde prej kategorive tjera për me i vendos te kategoria e investimeve kapitale, tregon për një intensitet të madh të punës që e ka qeveria komunale në Malishevë. Zakonisht qeverit vlerësohen në bazë të investimeve kapitale sa i kryen, sepse po mos të ishin investimet kapitale buxheti do të shfrytëzohet shumë lehtë. Ne si grup i NISMA-S e mbështesim këtë pikë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Përshëndetje për të gjithë!

Kryesues, unë gjithmonë kam thënë që merre Rregulloren lexoje dhe shpërfaqje dhe përmbajuri asaj. Seanca urgjente e ka një rend, nuk dërgohet materiali në mbledhje për një dokument kaq të rëndësishëm. Ky dokument dhe qarkorja e dytë që vjen, ta dikton se qfarë buxheti do të ketë për gjithë vitin 2024. Sa e kam parë ka një rritje të buxhetit në bazë të qarkorës për vitin 2024. Poashtu ka rritje dhe te investimet kapitale. Mirëpo ajo çka të bie në sy dhe ndoshta është dhe vërejtje që në disa kategori ka rritje dyfishim, disa janë dhe të arsyeshme. Te zyra e kryetarit 39,225.00E sa ka qenë në vitin 2022, tani kemi një dyfishim të zyrës së kryetarit. Zyra e Kuvendit poashtu prej 178,800.09E shkonë në 274,745.90E. Kjo mund të arsyetohet dhe me rritjen e pagave. Ka rritje në planifikim, në administratë dhe personeli, te buxheti dhe financat në drejtori, drejtorja e emergjencave, te bujqësia dhe pylltaria, te gjeodezia, te planifikimi urban.

Te kultuara dhe shëndetësia kemi një zvogëlim. Unë në një formë e kam lavdëru qeverisjen me një pikë, që ka një disiplinimi sa i përket të hyrave vetanake, mirëpo ka një mori kategorish që prapë nuk planifikohen që kanë me gjeneru të hyra vetanake. Te Drejtoria për buxhet dhe financa- licenca për shërbime profesionale, unë nuk po e kuptoj për qfarë shërbime po bëhet fjalë, në vitin 2023 është zero dhe

është zero dhe në vitin 2024. Licencat tjera për afarizëm është zero në viti 2023 dhe vazhdon të jetë zero në vitin 2024. Taks pjesmarrse në tender e kemi zero, këto kompanit ofertuese që ofertojnë për projekte të ndryshme, sigurisht që paguajnë një taks. Taks për çertifikata të lindjes është në vitin 2023 është 67,700E, ndërsa në vitin 2023 është 35,768E, është një zvogëlim dhe a është për shkak se po nxirren qertifikatat prej E-sistemit.

Taksa tjera në vitin 2023 është 20,841E, ndërsa në vitin 2024 planifikohet 15,400E. Taksa për demolim, zero është në vitin 2023 dhe zero planifikohet në vitin 2024. Këto kompanit që l rrënojnë objektet e vjetra, shkolla të vjetra, objekte të vjetra a paguajnë taksë për këtë shërbim.

Taksa komunale për leje gjërmimi është zero në vitin 2023, dhe planifikohet të jetë zero dhe në vitin 2024.

Taksa për shfrytëzimin e pronës publike në vitin 2023 është 25,000E, ndërsa në vitin 2024 planifikohet 18,000E.

Qiraja nga vendosja e objekteve tregtare në vitin 2023 është zero, prapë planifikohet zero në vitin 2024. Gjyba nga Inspektorati në vitin 2023 është 8,000E, ndërsa në vitin 2024 planifikohet të jetë 12,000E që është shumë e ulët.

Gjyba për deponit ilegale është zero, pse nuk planifikojmë me pas të hyra nga kjo kategori.

Taksa nga gjybat në trafik zero është vitin 2023 dhe zero planifikohet dhe në vitin 2024.

Taksa nga qirat e tokës bujqësore, taksa nga shrytëzimi i pyjeve, ne çdo ditë që e vërejm që po dëmtohen pyjet tona dhe prapë nuk kemi të hyra në këtë kategori.

Të hyra nga participimi i arsimit joformal-a organizohet mësimi joformal në shkollat tjera.

Të hyrat nga bibliotek, unë jam antarë dhe paguaj për antarsim aty, është mirë që ato të hyra të jenë këtu.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Mazreku: Përshëndetje për të gjithë!

Do të duhet që kjo Korniz afatmesme të ju nënshtrohet dëgjimeve publike, sepse kështu e don rregulli dhe Ligji. Dëgjimet publike, sa herë që ato mbahen, për të gjitha dokumentet të cilat janë të detyrueshme për më i mbajt ato dëgjime, ato ndikojnë dhe në nivelin e performancës. Sipas kësaj qarkore së parë, të cilën është përgadit ky dokument këtu përcaktohet vetëm kufiri i buxhetit për të gjitha organizatat buxhetore, brenda këti totali. Organizatat buxhetore kanë të drejtë me i shpërnda ato mjete, gjithmonë pa e cenu kategorin e pagave, sepse nuk mundemi me i lënë pa paga të gjitha ata punëtorë të administratës.

I kemi dy versione që janë paraqit: sipas qarkores buxheti është 19,895,800.00E që është një rritje me vitin aktual që jemi. Por, qeveria komunale e ka paraqit një buxhet total 20,395,806.00E, që është një të kalim i kufirit të buxhetit përcaktuar sipas qarkores buxhetore.

Te pagat dhe meditet e pash një rritje në krahasim me vitin aktual, ndoshta kjo është e domosdoshme për faktin që ka ndryshuar dhe ligji i pagave dhe disa prej punojësve të administratës kanë pasur ndryshime të koficienteve dhe pagave të tyre dhe kjo ka bërë ndryshimin e kësaj kategorie.

Te mallrat dhe shërbimet ishte një zvogëlim i buxhetit diku prej 16.78%. Kemi rritje te investimet kapitale, dhe investimet kapitale janë i vetemi investim qeveritar të cilat ndikojë drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik dhe kryesisht në zhvillimin e sektorit privat. Uroj që këto kërkesa të aprovohen në Ministri të Financave.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Labinot!

Labinot Gashi: Përshëndetje për të gjithë!

Unë dje e kam lexuar një njoftim ku tha që mënyra e thirrjes së mbledhjes është e jashtëligjshme. Mbledhja urgjente thirret në rastet e fatkeqësive natyrore. Kjo Korniz duhet me ju parprijë dhe debateve publike gjë që nuk ka ndodhur. Pse nuk ka ndodhur këto dëgjime është përgjegjësi e ekzekutivit. Në raste të tilla, kur janë rastet urgjente, se dhe kolegët që janë në KPF-unë i kam kritikuar në KPF-ë, unë e kam lexuar dje njoftimin ku thotë, me vota unanime rekomandohet për Kuvend dhe sot asnjë anëtarë i KPF-së nuk e mori fjalën me na binë se pse e kanë rekomanduar për Kuvend.

Nëse ekzekutivi nuk ka nevojë për Kuvend, mos de t'na flon hiq. Ata që i njohin principet bazë të buxhetit nuk guxojnë me i ba këto shkelje. Nuk janë 20,000,000.00E as të Kryesuesit as të Kryetarit, por janë të qytetarëve. Një prej principeve bazë të buxhetit është principi publik i buxhetit, sepse çdo qytetarë ka drejtë të dije se ku po shkon dhe centi i fundit i buxhetit. Ju kisha lut me ndal këtë praktikë të keqe. Faleminderit!

Argjend Thaçi: Urdhëro, Arlindë Rudi!

Arlindë Rudi: Përshëndetje për të gjithë!

Unë kam një pyetje për drejtorin: pse nuk është prezantuar qarkorja në kufijtë buxhetor, sa i ka prezantuar Ministria e Financave, sepse ne nuk e dimë sa ka qenë dhe sa është tash. Faleminderit!

Argjend Thaçi: Urdhëro, drejtor!

Blerim Thaçi: Nebih, pse ka qenë me vonesë kjo: Drejtoria e Financave këtë kërkesë e ka bërë më herët. Te aryeja e dëgjimeve publike dhe neve qarkorja na ka ardhur me vonesë nga Ministria dhe ka qenë një afat i shkurtër që të bëhen dëgjime publike. Kemi biseduar dhe me kryesuesin që kur të vie qarkorja e dytë do ti mbajmë dëgjimet publike dhe pas zgjedhje të kryetarëve të fshatrave do të kemi më të lehtë të kordinohemi me ata. Pjesa më e rëndësishme e dëgjimeve publike do të jetë për qarkoren e dytë.

Veton, kemi diskutuar dhe në KPF-ë, është e vërtetë që disa të dhëna jam munduar ti marr dhe te drejtorit e tjera, sepse ne si Drejtori e Financave prezantojmë pasqyrat e të hyrave, realizimit të shpenzimit dhe ne marrim të dhënat prej të gjitha drejtorive, sidomos te taksat dhe në bazë të asaj që kam marr informacion te pjesa e taksave, një pjesë që është zero hynë në kategorin e taksave tjera.

Pse është zvogëlimi i një pjesë të të hyrat vetanake, është për shkak të asaj që e kanë planifikuar zvogëlimin, mirëpo kemi rritjen në pjesë të tjera siq është qerdhja, nga urbanizmi.

Zyra e kryetarit pse është bërë dyfishimi kryesisht është rritja e pagave dhe zvogëlimi kemi në shëndetësi. Të Kuvendi ka rritje sepse kemi rritje të pagave.

Labinot, unë nuk mund të jap përgjigje pse është thirrur mbledhje urgjente, sepse nuk ka ndonjë qëshije të dëmeve, mirëpo është urgjente sepse është dita e fundit për aprovim.

Arlindë, unë i shpjegova dy format që sipas planifikimit të planifikuar të qeveris është 19,895,800.00E dhe ne duke i rritur të hyrat me 500.000.00E ka mbërritur në shumën 20,395,806.00E. Faleminderit!

Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih!

Nebih Bibaj: Mund të ketë ndryshim politikash, sepse këtu jemi ardhur të bëjmë politikë, ne i kemi qendrimet tona, ndërsa ju të juajat dhe vazhdojmë tutje. Ju e keni pushtetin dhe mendoni që jeni duke bërë mirë, ne mendojmë që jemi duke bërë opozitë të mirë, sigurisht që tjetër kush e vlerëson. Ne si grup i PDK-së jemi kundër kësaj forme që të shkojë kështu dhe në momentin kur të votohet ne e lëshojmë sallën. Derisa ne nuk ju duhemi juve, vazhdoni pa ne.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Mazreku: I mbeta borgj Vetonit, te të hyrat nga arsimi joformal. Një kohë ka qenë shkolla e Kijevës ka pasur të drejtën e këtij aktiviteti, mirëpo tani këtë aktivitet e ka Qendra e Kompetencës. Qendra e Kompetencës në nivel Republike është me organizat tjetër buxhetore që i kanë të gjitha qendrat e kompetencës në nivel. Të gjitha ato mjete shkojnë dhe planifikohen në buxhetin e asaj organizate dhe i kthen shkollës në bazë të kërkesave të shkollës.

Sa i përket Nebihut, se a na duhen këta dhe se a jemi duke i përdorur ne numrat, Nebih, unë kam qenë në vitin e kaluar në vend të Blerimit dhe ma arrogant që keni qenë ju mandatin e kaluar me numra asnjë asamble komunale nuk ka qenë në nivel të Republikës, e tani del aty dhe thu numrat. Po normal që numrat, kjo është demokracia dhe do ta mbajmë deri në fund të mandatit dhe besa dhe mandatin tjetër.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih!

Nebih Bibaj: Unë nuk e thash që jeni keq, por nuk është mirë me qit kuvendin poshtë. Ne i kemi penguar vetëm vendimet e kësaj për komunën. Shikojë vendimet që kanë përfunduar në procese gjyqësore.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Mazreku: Kryesues, pajtohem me Votonin, ka qenë mirë me na sjellë Rregulloren dhe fizikisht dhe në mënyrë elektronike. Pajtohem me Nebihun që kjo Korniz ti nënshtrohet dëgjimeve publike.

Argjend Thaçi: Urdhëro Halil!

Halil Morina: U përmend që këto para janë të qytetarëve, po para e qytetarëve është dhe po këta qytetarë kanë zgjedhur me votën e lirë se kush ka me menaxhu me paran publike. U përmend këtu që ka qëndrime publike. Po ka qëndrime politike pro dhe kundër. Ne jemi për këtë buxhet dhe ne kemi qenë pro këtij buxheti që i kemi bërë këto investime kapitale në qytet dhe dikush ka qenë kundër dhe në fund qytetari do ta vlersojë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Hamit!

Hamit Lima: Përshëndetje për të gjithë!

Nebih, diçka që është mirë duhet me përkrahë, nuk kemi nevojë me bërë debate jo të mira. Ne si grup i LDK-së e mbështesim.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Mirëinda!

Mirëinda Gashi: Desha të ndërlihem me kolegun nga NISMA, që tha që nuk e keni përkrahë asnjëherë punimet në qytetin e Malishevës dhe unë them se po kemi qenë kundër. Procesverbalet janë dhe gjithëka është e shkruar qytetarët munden me i pa dhe qëndrimet tona, asnjëherë nuk ka qenë PDK-ja kundër investimeve në komunën e Malishevës. Ne kemi qenë kundër qëndrimeve të juaja, në pazaret e juaja që i bëni. Është fjalimi im nuk jam kundër investimeve në komunë në qytet, por jam dhe me investu nëpër fshatra që janë mbetur mbrapa me punime.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë!

Desha ta jap një sqarim sa i përket qështjes së ekzekutivit dhe legjislativit. Kryetari Kastrati në aspektin ekzekutiv, sa i përket që e ka legjitimitetin e popullit dhe shumicës, mirëpo në aspektin e Kuvendit asnjë subjekt politikë nuk e ka shumicën dhe kjo e ka rëndësinë e saj. Është mirë që kur ka këso gjërash të rëndësishme për Këshilltarët e komunës së Malishevës në përgjithësi të mbahen takime paraprakisht dhe çdo herë është mirë me unifiku dhe me votu pro.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Dua të ju them kolegëve në pushtet NISMA dhe LDK-së, ne dhe në kuvend po mundohum me qenë konstruktiv sikur rasti i fundit me KPF-në mos me dalë kundër dhe mos me ja mohu këtë debat kuvendit. Kjo arroganca e juaj ende duke u thirr në të kaluarën dhe tani ta kthej në të njëjtën monedhë është pak e pa pranushme. Dhe dje i kemi diskutuar këto qështje që është dashur të vijë me kohë, që nuk është në procedurë të rregullt. Konsultohem shkurt dhe me kolegët tona që me gjasë dhe ne e lëshojmë sallën.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Mazreku: Veton, sado që ne sot mundemi me marr vendim diqka për shkak të numrave për asnjë moment të vetëm ju si opozitë, sikur ne në atë kohë që kemi qenë opozitë e kuvendit asnjëherë asnjë asambleistë nuk është fyer.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Krasniqi: Unë për secilin institucion kam respekt dhe sa i përket mospajtimeve ka ndodhur që në atë kohë ka pasur mospajtime, sepse në disa fshatra që kanë dhënë kontribut, sidomos gjatë kohës së luftës ju i keni pasur zero investime.

Argjend Thaçi: Shkojmë në votim të Kornizës Afatmesme 2024-2026.

Sallën e lëshojnë grupi nga PDK-ja, VV-ja, antarët nga LDK-ja Labinot Gashi dhe Adile Hoxha.

16 anëtarë jemi prezent dhe mund të vazhdojmë me seancën. Kush është për miratimin e Kornizës Afatmesme 2024-2026?

Me vota unanime, miratohet Korniza Afatmesme 2024-2026.


Ju falenderoj për pjesëmarrje!

Këtë mbledhje e shpalli të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në ora:10:30.

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina



Kryesuesi i Kuvendit

Argjend Thaçi

